



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 32

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 1

Prishtinë, më 6.6.2016, në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka dhe Adem Hoxha.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK, Fjolla Uka – KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve, masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2016;

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.5.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve;

Para jush, tha Flora Brovina, kryetare, e keni raportin me rekomandime për Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Ne si komisioni në këtë Projektligj kemi punuar mjaft. I kemi propozuar amendamentet tona dhe të njëjtat i kemi miratuar. Raportin me Amendamente e kemi përcjell tek katër komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje në lidhje me amendamentet tona dhe sot si Komision do ta miratojmë raportin me rekomandime.

Komisioni, pas diskutimit, njëzëri miratoi raportin dhe komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve, dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;

Kryetarja, theksoi se si Komisioni edhe në këtë Projektligj kemi punuar mjaft. I kemi propozuar amendamentet tona dhe të njëjtat i kemi miratuar. Raportin me Amendamente e kemi përcjell tek katër komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje lidhur me amendamentet tona dhe sot si Komision do të miratojmë raportin me rekomandime për Projektligjin dhe të procedojmë me tej.

Komisioni, pas diskutimit, njëzëri miratoi raportin dhe komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë;
2. Në versionin serbisht, të përmirësohet apo harmonizohet emri i Ligjit bazik në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

5. Të ndryshme.

Flora Brovina, kryetare, bëri të ditur se Komisioni në orën 11:00, do të pres një grup të rinjsh, përfaqësuesit e Iniciativës “*Rritu Shnetshëm*”, një grup i të rinjve të cilët synojnë që përmes hulumtimit dhe avokimit të kontribuojnë në ndryshimin e politikave dhe vetëdijësimin e

qytetarëve të Kosovës, për efektet anësore të pijeve energjike tek fëmijët. “*Iniciativë e të rinjve për ndalimin e konsumimit të pijeve energjike nga personat nën moshën 18 vjeç*”.

Rritu shnetshëm, kjo iniciativë doli si rrjedhojë e diskutimeve të gjata nga shumë të rinj entuziastë në Shkollën e Mediave të Reja, në shtator të vitit 2015, program i implementuar nga Instituti Kombëtar Demokratik – NDI dhe USAID.

Fadil Beka, rreth kësaj pike tha se kemi diskutuar edhe me herët lidhur me grupin e profesioneve të rrezikuara, të cilat gjatë kryerjes së shërbimit i janë ekspozuar rrezikut. Me sa kam informata me një akt nënligjor në SHSKUK, janë duke e rregulluar grupin e profesioneve të rrezikuara, ku i kanë përfshirë mjeket e emergjencës, infektologët, radiologët e të tjerë. Mirëpo, këtu nuk i kanë përfshirë kirurgët, të cilët vërtetë janë të rrezikuar dhe duhet të jenë pjesë e këtij grupi. Unë e shpreh shqetësimin ti se si mos të përfshihen edhe kirurgët në këtë grup.

Komisioni, pas diskutimit vendosi që në takimin që do të realizojmë gjatë monitorimit të Ligjit të Shëndetësisë, do të diskutojnë këtë çështje.

Flora Brovina, fillimisht i falënderoi përfaqësuesit e Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, të cilët ishin të pranishëm në mbledhje. Njëherësh, ajo njoftoi se në cilën fazë është procesi i nismës ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054, për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Në Komision u diskutua edhe për Projektligjin për Shërbimin Mjekësor Emergjent, me ç’rast pas diskutimit u vendos që të organizohet një punëtori katër ditore për shqyrtimin dhe finalizimin e Projektligjit për Shërbimin Mjekësor Emergjent.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA